



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primenë Mirënjohë 30-06-2016

Nr. i orasit Urg. broj	Numri i orarit	Shtojcë Prilog	Vlera Vredanost
	01-013/847		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti

Në bazë të Nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, në bazë të Nenit 7, paragrafi 3, Nenit 10, paragrafi 1, pika 1.4 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nenit 36 paragrafi 36.2, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të propozim vendimit të kryetarit të Komunës me Nr. të Protokollit 02-013/769, të datës 13.06.2016, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seance e mbajtur më datën 28.06.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

(Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Pronën e Paluajtshme të Komunës, Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti)

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë i jep në shfrytëzim afatgjatë, prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) viteve, pronën e paluajtshme të Komunës, parcelën Nr.54-2, me sipërfaqe 1231m², parcela Nr. 441-2 me sipërfaqe 309m² dhe parcelën Nr.71-2, me sipërfaqe 460m² ZK Sadovinë e Jerlive, Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti, për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Sadovinë e Jerlive.

Neni 2

Parcelat kadastrale të sipërshënuara, që janë objekt i këtij vendimi, i jepen në shfrytëzim afatgjatë, pa të drejtën e dhënies me qira, pa të drejtën e nënkontraktimit me personat e tretë, me mundësi të vazhdimit vetëm për destinacionin e përcaktuar më lartë, dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera.

Neni 3

Paluajtshmëria e cekur në Neni 1 të këtij vendimi, i jepet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pa kompensim, Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti, për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Sadovinë e Jerlive.

Neni 4

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nga neni 1 i këtij vendimi, bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti, me Nr.07-07/624 e datës 19.05.2016.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. Drejtorisë për Kadastër,
3. Drejtoria për Urbanizëm
4. Shërbimit të Kuvendit, dhe
5. Arkivit

